



A.nr.2016/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.2016/2025 të datës 11.12.2025, të parashtruar nga ankuesi M.A, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.03.2026 mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.2016/2025, e datës 11.12.2025, e parashtruar nga ankuesi, M.A.

II. Anulohet Vendimi me numër protokolli 10484 i datës 12.11.2025, i Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe Akt emërimi i datës 14.11.2025, për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Siguri Rrugore në kuadër të Departamentit për Menaxhimin e Rrugëve.

III. Obligohet Ushtruesi i Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, M.A (në tekstin e mëtejshëm referuar: ankuesi), më datë 11.12.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 10484 të datës 12.11.2025, të Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.12.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa më datë 29.12.2025, ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Tutje, Kryetari i Këshillit pas pranimi të kërkesës së Kryetares së Kolegjit përmes Vendimit me numër VK/2026 dhe numër të protokollit 336/2026 të datës 21.01.2026, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.2016/2025, të parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit), për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7822/2025, të datës 11.12.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën me numër protokolli 11124 të datës 02.12.2025; Vendimin me numër protokolli 10484 të datës 12.11.2025; Kërkesën për transferim të datës 11.11.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 24.12.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 29.12.2025; Vërtetimin e marrëdhënies së punës të F.M; Diplomën me Nr.02-3472/95-2645; Shkresë në gjuhën kroate; Përshkrimin e detyrave të punës të pozitës Udhëheqës i Divizionit të Sigurisë Rrugore; Kontratën e e datës 30.11.2011; Kontratën e datës 12.06.2002; Kontratën e punës të datës 25.06.2003; Kontratën e punës të datës 19.05.2006; Kontratën e punës të datës 06.04.2009; Akt emërimit të datës 11.07.2014; Akt emërimit të datës 03.02.2012; Vendimin me Nr.3147/2015 të datës 06.07.2015; Vendimin me Nr.5941/2015 të datës 15.12.2025; Vendimin me numër protokolli 3735 të datës 24.04.2018; Vendimin me numër protokolli 7903 të datës 14.09.2021; Akt emërimit me Nr.33/2025 të datës 12.05.2025; Vendimin me numër protokolli 6407/25 të datës 28.08.2025; Akt emërimit të datës 14.11.2025; Vendimin me numër protokolli 10836 të datës 21.11.2025; Vendimin me numër protokolli 3434 të datës 21.04.2021; Akt emërimit të datës 30.12.2014; Vendimin me numër protokolli 1808 të datës 04.03.2022; Vendimin me numër protokolli 7703 të datës 20.08.2025; Vërtetimin e marrëdhënies së punës të M.A; Diplomën me Nr.345 të datës 26.06.2008; Diplomën me Nr.160 të datës 28.06.2011; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Mbështetjes Teknike, Pronave, Sigurisë Rrugore dhe Peshoreve të datës 14.08.2018; Kontratën e punës të datës 14.07.2008; Kontratën e punës të datës 01.04.2009; Kontratën e punës të datës 10.02.2010; Kontratën e punës të datës 20.05.2011; Akt emërimit të datës 18.01.2012; Akt emërimit të datës 08.07.2014; Vendimin me Nr.45/2014 të datës 09.01.2014; Vendimin me Nr.113/2016 të datës 08.01.2016; Vendimin me Nr.3101/2018 të datës 05.04.2018; Vendimin me numër protokolli 9253 të

datës 01.10.2018; Vendimin me Nr.9451 të datës 08.10.2018; Vendimin me numër protokolli 588 të datës 18.03.2025; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit me numër protokolli 3366 të datës 13.04.2018.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është **e bazuar, sepse;**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit me numër protokolli 3366 të datës 13.04.2018, është i punësuar në pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit të Mbështetjes Teknike, Pronave, Sigurisë Rrugore dhe Peshoreve, në kuadër të Departamentit të Menaxhimit të Rrugëve të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës *(në tekstin e mëtejme referuar: MMPHI)*.

Më tej, Ushtruesi i Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, përmes Vendimit me numër protokolli 10484 të datës 12.11.2025, Udhëheqësin e Divizionit të Transportit të Mallrave dhe Mallrave të Rrezikshme, në Departamentin e Transportit të Përgjithshëm, e ka transferuar në mënyrë të përhershëm për interes të institucionit, në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Siguri Rrugore në kuadër të Departamentit për Menaxhimin e Rrugëve.

Ankuesi, kundër Vendimit me numër protokolli 10484 të datës 12.11.2025 të bashkëngjitur me kërkesën për transferimin, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe ligjore të: nenit 24, 49 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; nenit 36 dhe 59 të Ligjit Nr.08/L-275 për Rrugët; nenit 12, 22, 23, 26, 28, 38 deri te neni 50 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik; nenit 10 paragrafit 2 të Rregullores (QRK) Nr.01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura; paragrafit 4 dhe 8 të nenit 11 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil; nenit 7, 16, 19 dhe 21 të Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil; pikës IV nr.9, pikës V nr.2.7, pikës VI nr.1, nr.1.2.8 dhe nr.2 të Udhëzuesit Nr.02/2022 për Organizimin Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit; nenit 93 nën paragrafit 1.2 (shtojca 2) të Rregullores (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të MMPHI-së; nenit 4, 6, 7, 8, 30, 31, 48 dhe 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kundërshtim me edhe me vendimet e KPMSHCK-së të nxjerra lidhur me procesin e transferimit në MMPHI. Si rrjedhojë, ankuesi kërkon aprovimin e tërësishëm si të bazuar të ankesës dhe shfuqizimin e aktit të kontestuar.

Kolegji i Këshillit, në ndërlidhje të ankesës dhe çështjes kontestuese, thekson se sipas Vendimit me Nr.073/2024 të datës 29.03.2024 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në

Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, sipas së cilës rezulton se në këtë ministri janë paraparë Departamentet dhe Divizionet përkatëse, ku në kuadër të Departamentit për Menaxhimin e Rrugëve, parashihen këto divizione: ***Divizioni i Mirëmbajtjes së Rrugëve; Divizioni i Ndërtimit të Rrugëve; Divizioni i Menaxhimit të Pronave, Kycjeve dhe Instalimeve; dhe Divizioni i Sigurisë Rrugore***, ndërsa në kuadër të përgjegjësisve ligjore, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme me Vendimin me Nr.2392/2024, të datës 29.11.2024, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës, i cili më datë 03.03.2025 ka miratuar Raportin e punës me Nr.191, dhe propozimet lidhur me ristrukturimin për këtë institucion.

Ndërsa, bazuar në të dhënat zyrtare që Këshilli posedon për lëndë të shqyrtuara, rezulton se Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, nëpunësin civil të kësaj ministrie z. B.T, nga pozita e “Udhëheqësit të Divizionit për Pyetës”, përmes Vendimit me Nr.590 të datës 18.03.2025, e ka transferuar në pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Autorizime dhe Licenca ” në Departamentin e Mbrojtës dhe Rrezatimit dhe Siguri Bërthamore.

Nëpunësi civil z. B.T, kundër Vendimit me Nr.590 të datës 18.03.2025, lidhur me transferimin e tij pas ristrukturimit me datë 30.04.2025, ka parashtruar ankesë pranë Këshillit, ndërsa, Këshilli, përmes Vendimit A.nr.786/2025 të datës 05.08.2025, ka aprovuar ankesën e nëpunësit civil në fjalë, dhe për rrjedhojë, **ka shfuqizuar:**

-Vendimin me Nr.7781/24 të datës 25.11.2024, të nxjerr nga U.d. Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, me të cilin ka bërë aprovimin e ndryshimeve dhe plotësimit e përshkrimeve të punës të hartuar nga “Grupi i Vlerësimit për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës sipas Vendimit Nr.2338/24 i datës 05.04.2024;

-Raportin e Punës dhe Propozimet për Ristrukturim i datës 03.03.2025 për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; si dhe,

-të gjitha Vendimet dhe procedurat që kanë rrjedhë nga Raporti i Punës dhe propozimet për Ristrukturim në kuadër të MPHI të datës 03.03.2025.

Nisur nga ajo që u theksua si më sipër rezulton se Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ende nuk e ka përfunduar procesin e ristrukturimit në zbatim të Rregullores (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e duke qenë se pozita që mbanë ankuesi sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit me numër protokolli 3366 të datës 13.04.2018, Udhëheqës i Divizionit të Mbështetjes Teknike, Pronave, Sigurisë Rrugore dhe Peshoreve, hynë në kuadër të Departamentit të Menaxhimit të Rrugëve, e në të cilin parashihen katër (4) divizione, në mesin e tyre edhe pozita e Udhëheqësit të Divizionit për Siguri Rrugore, Kolegji i Këshillit, vlerëson se transferimi në mënyrë të përhershme për interes të institucionit, i një nëpunësi civil nga një departament tjetër i organit përkatës të punësimit, si në rastin konkret të Udhëheqësit të Divizionit të Transportit të Mallrave dhe Mallrave të Rrezikshme, në Departamentin e Transportit të Përgjithshëm, në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Siguri Rrugore në kuadër të Departamentit për Menaxhimin e Rrugëve, pa

përfunduar procesi i tërësishëm i ristrukturimit ia cenon ankuesit drejtpërdrejt të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës që rrjedhin nga akt emërimi në fuqi, duke u vepruar kështu në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ngase, në rrethanat e rastit konkret transferimi në mënyrë të tillë krijon pasiguri juridike dhe konfuzitet për ankuesin për shkak të pozitës që mbanë, ashtu që, organi përkatës i punësimit fillimisht duhet të përfundoj procesin e ristrukturimit, dhe vetëm atëherë të ndërmarr veprime procedurale për plotësimin e pozitave të lira në mënyrë të përhershme, dhe se mungesa e këtyre veprimeve cenon parimet e përgjithshme të shërbimit civil, për faktin se krijon paqartësi të theksueshme në përmbushjen e detyrave funksionale nga nëpunësit civil, deri në atë pikë sa që për të njëjtën pozitë ka dy të emëruar.

Tutje, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht Nenit 65, i cili përcakton se “1. Nëpunësja/i civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil. Për rastet kur nëpunësja/i civil është e nivelit drejtues të ulët, mesëm apo të lartë, transferimi sipas këtij neni bëhet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar. 2. Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Përgatitja profesionale e nëpunëses/it që transferohet duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet. 4. Transferimi i nëpunëses/it civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësen/in e drejtpërdrejtë, udhëheqësen/in më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunëses/it civil. 5. Transferimi i nëpunëses/it civil në një institucion tjetër të shërbimit civil, bëhet në pajtim me pëlqimin e nëpunëses/it dhe me marrëveshje në mes të institucioneve. 6. Refuzimi për transferimin e përhershëm mund të bëhet vetëm në këto raste: 6.1. kur gjendja e saj/tij shëndetësore, dëshmuar me vërtetim mjekësor e pamundëson transferimin; 6.2. nëse vendi ku do të transferohet gjendet më shumë se njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunëses/it civil; 6.3. për arsye objektive të dëshmuar që e pamundëson transferimin. 7. Qeveria me akt nënligjor, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike miraton rregullat për zbatimin e këtij neni...”; si dhe Rregullores (QRK) nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, përkatësisht Nenit 11, ku përcaktohet se: “1. Nëpunësi civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në një vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil. 2. Për rastet kur nëpunësi civil është i nivelit të ulët, mesëm apo të lartë drejtues, transferimi sipas këtij neni bëhet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar. 3. Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër që punëson nëpunës civilë. 4. Transferimi i nëpunësit civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, udhëheqësin më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunësit civil. 5. Transferimi i nëpunësit civil në një institucion tjetër që punëson nëpunës civilë, bëhet në pajtim me pëlqimin e nëpunësit dhe me marrëveshje në mes të institucioneve. 6. Refuzimi për transferimin e përhershëm mund të bëhet vetëm në këto raste: 6.1. kur gjendja e tij shëndetësore, dëshmuar me vërtetim mjekësor, e pamundëson transferimin; 6.2. nëse vendi ku do të transferohet gjendet më shumë se njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunësit civil; dhe 6.3. për arsye objektive të dëshmuar që e pamundëson transferimin. 7. Arsyet objektive për refuzim të transferimit sipas nën paragrafit 6.3 të paragrafit 6 të këtij neni, vlerësohen rast pas rasti nga drejtuesi

më i lartë administrativ i institucionit dhe dëshmohen me dëshmitë përkatëse nga nëpunësi. 8. Arsyetimi i vendimit të transferimit të përhershëm në interes të institucionit, përmban vlerësimin se nëpunësi plotëson kriteret e pozitës së punës ku transferohet. Ky vlerësim kryhet nga NjMBNj e institucionit ku nëpunësi është i punësuar...”; dhe se përveç asaj që u konstatua si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se transferimi në mënyrë të përhershëm për interes të institucionit, përmes Vendimit me numër protokolli 10484 të datës 12.11.2025, është realizuar edhe përmes mos respektimit dhe shkeljeve të këtyre dispozitave ligjore, të cilat përcaktojnë rregullat dhe procedurat për transferimin e përhershëm për interes të institucionit, ngase akti kontestues me ankesë fillimisht nuk përmban fare arsyetim se nëpunësi civil i transferuar në mënyrë të përhershme në pozitën përkatëse posedon përgatitje profesionale në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën është transferuar apo vlerësimin nga NjMBNj e institucionit ku i njëjti është i punësuar, se nëpunësi plotëson kriteret e pozitës së punës ku transferohet, nga rrjedhë se në rastin përkatës kemi edhe një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm e i paqartë, i cili në kuptim të nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative është i barabartë me mungesën e tij, dhe se ndër të tjera, ky transferim po ashtu rezulton të jetë realizuar edhe pa pëlqimin e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të Udhëheqësit të Divizionit të Transportit të Mallrave dhe Mallrave të Rrezikshme, për më tepër sipas Kërkesës për transfer të datës 11.11.2025, rrjedhë se udhëheqësi i drejtpërdrejtë as nuk është mbajtur i njoftuar lidhur me ndërmarrjen e këtij veprimi.

Si pasojë e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 10484 të datës 12.11.2025, për transferimin në mënyrë të përhershme, të Udhëheqësit të Divizionit të Transportit të Mallrave dhe Mallrave të Rrezikshme, në Departamentin e Transportit të Përgjithshëm, në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Siguri Rrugore në kuadër të Departamentit për Menaxhimin e Rrugëve, rezulton se të njëjti nëpunës me datë 14.11.2025, i është lëshuar Akt emërimi me mandat katër (4) vjeçar për pozitën përkatëse të punës, duke theksuar datën e fillimit 17.06.2025, pra përafërsisht pesë (5) muaj ditë kalendarike më përpara se data e nxjerrjes së vendimit të transferimit të tij, e në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, në mënyrë që i njëjti akt të jetë në pajtim me normat ligjore për transferimin e përhershëm, ku sipas tyre parashihet qartë se për rastet kur nëpunësi civil është i nivelit të ulët, mesëm apo të lartë drejtues, transferimi bëhet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar, dhe pavarësisht konstatimeve se me rastin e realizimit të këtij transferimi ankuesit i cenohet siguria juridike apo të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës, organi i punësimit tek data e fillimit është dashur të sqaroj saktësisht datën e fillimit të ushtrimit të kësaj pozite të zyrtarit përkatës, në atë mënyrë që të theksoj se nga data 17.06.2025 i ka filluar mandati i punës për pozitën e punës paraprake para transferimit, atë të Udhëheqësit të Divizionit të Transportit të Mallrave dhe Mallrave të Rrezikshme, në Departamentin e Transportit të Përgjithshëm, ndërsa nga data e transferimit të vendos datën e fillimit të pozitës konkrete.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se pa përfunduar procesi i ristrukturimit brenda institucionit, gjegjësisht sistemimit të nëpunësve civil sipas Rregullores (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në këtë kontekst dhe me qëllim të evitimit të shkeljeve të së drejtave themelore nga

marrëdhënia e punës së nëpunësve civil, Vendimi me numër protokolli 10484 i datës 12.11.2025, dhe Akt emërimi i datës 14.11.2025 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Siguri Rrugore në kuadër të Departamentit për Menaxhimin e Rrugëve, i Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, konsiderohen të paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.7 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që akti i kundërshtuar me ankesë e prej të cilit ka derivuar edhe akti e tjetër i sapo theksuar, është kundërshtim me nenin 8 dhe 65 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, nenin 4, 6, paragrafi 3 të nenit 47, paragrafit 2 të nenit 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe për rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi sikurse në dispozitiv të vendimit për aprovimin e ankesës dhe anulimin e aktit kontestues, si dhe atyre të cilat kanë rrjedhë si pasojë e e nxjerrjes së tij.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.2016/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit M.A;
- U.D Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqëses së Divizionit të Personelit të MMPHI-së; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.